



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 dhe nenit 5 të Ligjit nr. 03/l-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 83 dt. 29 tetor 2010 dhe të nenit 3 Ligjit nr. 05/l-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 17 dt. 30 qershor 2015, në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht 2015 miraton:

R R E G U L L O R E NR. 02/2015

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore rregullon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (këtu e tutje “KPK”).
2. Procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së do të jetë i hapur, transparent, në përputhje me parimet e konkurrencës, objektivitetit, paanshmërisë, përfaqësimit adekuat gjeografik për anëtarët prokurorë, barazisë gjinore dhe shumë-etnicitetit.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- “KPK” nënkupton Këshilli Prokurorial i Kosovës.
“KZ KPK”nënkupton Komisioni Zgjedhor i KPK-së.
“ZKPSH”nënkupton Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.
“LKPK” nënkupton Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
“KPSH” nënkupton Kryeprokurori i Shtetit.
“PSRK”nënkupton Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.
“PTH”nënkupton Prokuroria Themelore.
“OAK”nënkupton Oda e Avokatëve të Kosovës.
“UP” nënkupton Universiteti i Prishtinës.
“SHC” nënkupton Shoqëria Civile.
“OJQ” nënkupton Organizatë Jo-Qeveritare.

Neni 3

Parimet e përgjithshme dhe kushtet e procesit të zgjedhjes për anëtarë të KPK-së

3.1 KPK siguron që procesi i zgjedhjes së anëtarëve prokurorë të KPK-së dhe procesi i emërimit të anëtarëve jo-prokurorë të saj të mbështetet në parimet e konkurrencës, transparencës, paanshmërisë, objektivitetit, barazisë gjinore dhe shumë-etnicitetit.

3.2 KPK siguron që përbërja e KPK-së të jetë në pajtueshmëri me kërkesat kushtetuese dhe ligjore të barazisë gjinore dhe shumë etnicitetit.

3.3 Zgjedhja dhe emërimi i anëtarëve të KPK-së mbështetet në performancë të lartë profesionale, reputacion moral dhe integritet personal.

Neni 4

Mos-përputhja me ushtrimin e detyrës së prokurorit anëtarë

4.1 Anëtarët prokurorë të KPK-së nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyrën e kryeprokurorit në cilindo prokurori të Kosovës, përjashtimisht Kryeprokurorit të Shtetit.

4.2 Kandidati i zgjedhur për anëtar të KPK-së i cili në kohën e zgjedhjes ushtron pozitën e Kryeprokurorit, duhet të paraqes dorëheqjen e saj/tij nga pozita e Kryeprokurorit para dhënies së betimit.

Neni 5

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë në KPK

5.1 Kandidatët prokurorë për anëtarë të KPK-së, duhet të përmbushin kriteret për zgjedhje si në vijim:

5.1.1 Nuk duhet të kenë ndonjë masë të shqiptuar disiplinore në tri vitet e fundit.

5.1.2 Nuk duhet të jenë të dënuar për veprë penale, me përjashtim të kundërvajtjes.

Neni 6

Përfaqësimi shumë-etnik dhe gjinor në KPK

6.1 Në pajtim me nenin 3 parag. 3 i Ligjit nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, KPK do të sigurojë që përbërja e KPK-së të reflektojë natyrën shumë etnike dhe barazinë gjinore.

6.2 KPK do të sigurojë që së paku një (1) anëtarë nga komunitetet jo-shumicë të jetë anëtarë i KPK-së.

6.3 Varësisht nga struktura gjinore e prokurorive, KPK do të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë së paku tre (3) anëtarë të gjinisë femërore.

6.4 Para shpalljes së konkursit, KPK do të beje vlerësimet paraprake mbi nivelin e përfaqësimit shumë etnik dhe gjinor për secilën prokurori përkatëse në të cilën do të zhvillohen zgjedhjet.

6.5 KPK me shpalljen e zgjedhjeve, bazuar në vlerësimin nga paragrafi 4 i këtij neni do të nxjerrë udhëzim për mënyrën e përfaqësimit shumë etnik dhe gjinor në prokurorinë përkatëse.

Neni 7

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve

7.1 KPK merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të KPK-së nga radhët e prokurorëve, së paku tre muaj para përfundimit të mandatit të anëtarit të KPK-së.

7.2 Në rastet kur mandati i ndonjërit nga anëtarët e KPK-së pushon para përfundimit të mandatit të rregullt, KPK do të merr vendim dhe shpall konkursin menjëherë. Procedura e zgjedhjes do të zhvillohet në afat sa më të shkurtë.

7.3 Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve duhet të përmbajë udhëzim të veçantë për prokuroritë përkatëse ku do të zhvillohen zgjedhjet përfshirë datën, vendin dhe kohën e zgjedhjeve si dhe strukturën etnike dhe gjinore. Shpallja do të përfshijë edhe njoftimin për përbërjen e Komisionit të themeluar sipas nenit 8 të kësaj Rregullore.

Neni 8

Mandati i Komisionit zgjedhor

8.1 KPK themelon Komisionin Zgjedhor të KPK-së për zhvillimin e zgjedhjeve si dhe njofton Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse me vendimin për themelimin e KZ KPK.

8.2 KZ KPK përbëhet nga tre (3) anëtarë me përbërjen si në vijim:

8.2.1 Një anëtar jo prokuror i KPK-së – Kryesues i KZ KPK.

8.2.2 Një prokuror nga ZKPSH

8.2.3 Një zyrtar i Sekretariatit të ZKPSH-së.

8.3 KPK do të zgjedh nga një zëvendës për secilin anëtar të KZ KPK-së nga paragrafi i 3 i këtij neni.

8.4 KZ KPK do të ketë mandat për zbatimin e vendimit të KPK-së për zhvillimin e zgjedhjeve. KZ KPK do t'i raportojë KPK-së për procesin zgjedhor.

8.5 KZ KPK vlerëson nëse të nominuarit për anëtarë të KPK-së nga radhët e prokurorëve plotësojnë kriteret e parapara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit të KPK-së përfshirë

plotësimet dhe ndryshimet e datës 15 qershor 2015 dhe nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregullore.

Neni 9

Procedura e nominimit dhe votimit

9.1 KZ KPK me pranimin e vendimit për fillimin e procesit zgjedhor do të bëjë përgatitjet e nevojshme për procesin e zgjedhjes.

9.2 Kryesuesi i KZ KPK do të njoftojë Kryeprokurorin përkatës mbi afatet dhe procedurat tjera zgjedhore. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse është i obliguar të njoftojë menjëherë të gjithë prokurorët e asaj prokurorie me njoftimin e mësipërm të KZ KPK-së.

9.3 Kandidatura për anëtar të KPK-së do t'i paraqitet me shkrim KZ KPK-së, më së largu 10 ditë nga dita e njoftimit të Kryeprokurorit nga ana e KZ KPK-së, sipas paragrafit paraprak të këtij neni.

9.4 Cilido prokuror nga prokuroria përkatëse ku zhvillohen zgjedhjet kane te drejtën të jenë të nominuar për anëtar të KPK-së.

9.5 KZ KPK nëse konstaton se ndonjë nga kandidatet e nominuar nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 8 paragrafin 5 të kësaj Rregullore nxjerr vendim brenda 15 ditë për mos-pranim të kandidaturës së kandidatit të nominuar.

9.6 Kundër vendimit të KZ KPK-së nga paragrafi paraprak i këtij neni, kandidati i pa kënaqur mund të ushtrojë ankesë në KPK brenda 3 ditë nga dita e pranimi të vendimit.

9.7 KPK do ta shqyrtojë ankesën në afat prej 5 ditë nga dita e pranimi të ankesës.

9.8 Lista përfundimtare e kandidatëve të nominuar për secilën prokurori do të publikohet së paku 5 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

9.9 Procesi i votimit fillohet vetëm nëse janë të pranishëm mbi 51% të prokurorëve të prokurorisë përkatëse.

9.10 Secili prokuror nga prokuroria përkatëse, ka të drejtë të marrë pjesë në votim.

9.11 Procedura e votimit për zgjedhjen e kandidatit për anëtarë të KPK-së duhet të jetë e fshehtë.

9.12 Lista votuese do të përmbajë emrat e kandidatëve të nominuar nga prokuroria përkatëse sipas rendit alfabetik.

9.13 Prokurorët duhet të votojnë vetëm një kandidat nga lista votuese, përveç nëse KPK përcakton ndryshe me udhëzim.

9.14 Nëse dy apo më shumë kandidatë kanë numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet vetëm për ata kandidatë. Nëse edhe pas herës së dytë kandidatët marrin numrin e njëjtë të votave, zgjedhja bëhet me short.

9.15 Prokurori i cili siguron më së shumti vota nga lista votuese, do të zgjidhet anëtar i KPK-së nga prokuroria përkatëse.

9.16 Secila prokurori përkatëse zgjedhë nga një prokurorë për anëtarë të KPK-së.

9.17 Prokurorët e zgjedhur kanë të drejtë që në çdo fazë të tërhiqen nga zgjedhja për anëtar në KPK.

9.18 Pas përfundimit të procesit zgjedhor, KZ KPK ia përcjellë KPK-së një raport mbi procedurën e nominimit dhe zgjedhjes. Raporti do të përfshijë informatat si në vijim:

9.18.1 Shpalljen e fituesit;

9.18.2 Numrin e votave për secilin kandidat dhe procedurën e zhvilluar, përfshirë edhe çfarëdo procedure për votim të dytëm, dhe

9.18.3 Një përshkrim të detajuar për çfarëdo shkelje procedurale apo ankesa nga palët e pranishme dhe rekomandim nëse procedura duhet të përsëritet.

9.19 KPK bazuar në rekomandimin e KZ KPK, mund të vendosë se procedura e nominimit dhe zgjedhjes duhet të përsëritet. Baza për një vendim të tillë duhet të jetë qartë e theksuar.

Neni 10

Kërkesa për nominimin e anëtarit jo-prokurorë të KPK-së nga ana e OAK dhe fakulteteve juridike të Republikës së Kosovës

10.1 KPK kërkon nominimin e së paku tre (3) anëtarëve nga OAK, për anëtarë të KPK nga radhët e avokatëve. Procedura e nominimit organizohet nga vetë institucioni përkatës.

10.2 KPK kërkon nominimin e së paku tre (3) anëtarëve të fakulteteve juridike të Republikës së Kosovës për anëtarë të KPK nga radhët e profesorëve. Procedura e nominimit organizohet nga vetë institucioni përkatës.

10.3 KPK tre muaj para përfundimit të mandatit të anëtarit jo-prokurorë nga radhët e OAK, Fakulteteve Juridike të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile e njofton Kuvendin e Kosovës.

Neni 11

Shpallja e konkursit për anëtarin e KPK-së nga shoqëria civile

11.1 KPK shpallë konkurs për anëtarë të KPK-së nga radhët e shoqërisë civile tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të anëtarit të shoqërisë civile. Shpallja publike duhet të jetë e hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën e përditshme në Kosovë.

11.2 Konkursi do të përfshijë udhëzime për OJQ-të mbi dorëzimin e nominimeve, njoftimin se kandidatët do t'i nënshtrohen kontrollit të KPK-së rreth plotësimit të kriterëve ligjorë të kandidatëve të nominuar si dhe procedurën vijuese të KPK-së për përcjelljen e nominimeve në Kuvendin e Kosovës.

11.3 Shpallja për vendet e lira do të inkurajojë edhe nominimet nga radhët e minoriteteve dhe barazinë gjinore.

Neni 12

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë nga shoqëria civile

12.1 KPK pas pranimit të nominimeve nga shoqëria civile, do të themelojë një Komision të veçantë për shqyrtimin e përshtatshmërisë së kandidatëve të nominuar.

12.2 Komisioni do të shqyrtojë të gjitha nominimet dhe do të sigurohet se kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara me ligj.

12.3 Komisioni do të përgatis një raport për KPK-në me listën e të gjithë kandidatëve të nominuar të cilët i plotësojnë kriteret ligjorë dhe ata kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kriteret ligjorë.

12.4 KPK i përcjell Kuvendit të Kosovës listën përfundimtare të kandidatëve të nominuar për pozitën përkatëse për anëtarë nga shoqëria civile, përfshirë edhe çfarëdo vërejtje të Komisionit mbi mos-përshtatshmërinë e cilitdo kandidat të nominuar.

Neni 13

Betimi i anëtarëve të KPK-së

Mandati i anëtarit të ri të KPK-së fillon pas dhënies së betimit në takimin e parë të KPK-së pas zgjedhjes së tyre.

Teksti i betimit është si në vijim:

“Solemnisht deklaroj dhe premtoj se do t'i kryejë funksionet në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale me qëllim të përmbushjes së obligimit Kushtetues dhe Ligjor”.

Neni 14

Procedura për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të KPK-së

14.1 Anëtarët e KPK-së nga radhët e veta zgjedhin Kryesuesin dhe Zëvendëskryesuesin e KPK-së nga anëtarët prokurorë me mandat tre (3) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

14.2 Të zgjedhurit në këtë pozitë nuk e zgjatë mandatin e tij/saj në KPK.

14.3 Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesi zgjidhen me votim të fshehtë me 2/3 votave të anëtarëve të pranishëm të KPK-së.

14.4 Kryesuesi i KPK-së pezullon pozitën e Prokurorit të Shtetit pas zgjedhjes si Kryesues i KPK-së. Ai ka të drejtë t'i kthehet pozitës në të cilën ka shërbyer para se të zgjidhet Kryesues.

Neni 15

Dispozitat kalimtare

15.1 Deri në hyrjen në fuqi të nenit 3 Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, KPK do të vazhdojë punën me këtë përbërje.

15.2 Anëtarët aktual të KPK-së kanë për detyrim që të përgadisnin zgjedhjet për anëtarët e rinjë të KPK-së, me qëllim të ruajtjes së funksionalitetit.

15.3 Mandati i anëtarëve të KPK-së që vazhdon pas datës 31 dhjetor 2015, do të rregullohet me ligj.

15.4 Kryeprokurori i Shtetit thërret dhe e kryeson mbledhjen e KPK-së deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ri të KPK-së.


Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga KPK.

Prishtinë, më 7 gusht 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës
Kryesues, Aleksander Lumezi

The image shows a circular official stamp of the Kosovo Judicial Council (KPK). The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top and "Këshilli Prokurorial i Kosovës" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Kosovo. Below the stamp, there is a handwritten signature in black ink, which appears to be "A. Lumezi".